



Prishtinë: 30.09.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1293_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2078_07_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **15.09.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 30.09.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin R.A. nga Komuna e Ferizajt, me shifër të konsumatorit **DFE 10171** si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_2078_07_20 i datës 06.07.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 15.09.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, për konsumatorin R.A. nga Komuna e Ferizajt, lidhur me kontestimin e faturave të muajve 08 dhe 09 të vitit 2017, nën pretendimet se edhe pse faturat janë të larta, kjo nuk do të thotë që konsumatori nuk e ka shpenzuar energjinë elektrike të faturuar dhe se leximet e bëra janë lexime me pajisjet HHU, ku të dhënat janë marrë në mënyrë automatike "me sondë", e në këtë mënyrë është evituar gabimi në lexim. Gjithashtu, përfaqësuesit e KESCO pretendojnë se nëse njehsori nuk do të bënte matje të saktë në periudhën e kontestuar, atëherë e njëjta do të kishte ndodhur edhe për 20 ditë të muajit tetor. Por që, me të njëjtin njehsor, shpenzimi është i përafërt sikurse me njehsorin e vjetër dhe se shpenzimi për periudhën kontestuese është real dhe i faturuar drejt sipas shpenzimit të bërë nga konsumatori.

Bazuar në këtë, KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE_V_2078_07_20, në lidhje me shifrën DFE 10171.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se edhe pse faturat janë të larta, kjo nuk do të thotë që konsumatori nuk e ka shpenzuar energjinë elektrike të faturuar dhe se leximet e bëra janë



lexime me pajisjet HHU (ang. Held Hand Unit – HHU), ku të dhënat janë marrë në mënyrë automatike “me sondë”, e në këtë mënyrë është evituar gabimi në lexim, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e mëvonshme dhe të mëhershme vërteton se konsumatori ka luhatur në shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në periudhën kontestuese 08-09/2017. Për këtë qëllim, Bordi i ZRRE-së ka bërë krahasimin e shpenzimeve të konsumatorit me dy njehsorët elektrik nr.15792884 dhe nr.69076545 për periudha të njejta kohore. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike, shpenzimet mujore të konsumatorit me njehsorin elektrik kontestues nr. 16068219 janë:

- për periudhën 08/2015 është 476 kWh/muaj;
- për periudhën 09/2015 është 543 kWh/muaj;

kurse me njehsorin e ri nr. 69076545, shpenzimet e konsumatorit janë:

- për periudhën 08/2018 është 611 kWh/muaj;
- për periudhën 09/2018 është 583 kWh/muaj;
- për periudhën 08/2019 është 629 kWh/muaj dhe
- për periudhën 09/2019 është 628 kWh/muaj.

Pra, Bordi i ZRRE-së, bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë, ka konstatuar se konsumatori në periudhën kontestuese ka pasur rritje të shpenzimit prej 1,252 kWh në muajin gusht 2017 dhe prej 1,102 kWh në muajin shtator të vitit 2017, e që as për së afërmi nuk përkon me shpenzimet që konsumatori i ka bërë në periudhat e cekura më lartë, si në vitin 2018 dhe në vitin 2019. Andaj, pretendimet e KESCO-s si të tilla, i vlerësojmë si të paqëndrueshme.

Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se sipas procesverbalit të shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.23445 të datës 22.11.2017, është konstatuar se njehsori elektrik nr.15792884 nuk është në rregull, njehsori elektrik bllombat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka, nuk ka probleme me sistemet matëse, si dhe që kanë evidentuar si vërejtje se njehsori elektrik ka te paraqitur simbolin e ziles dhe nuk mund te lexohen EL dhe LP, por që gabimi në matje është 0.11%. Andaj bazuar në këtë Bordi i ZRRE thekson se bazuar në procesverbalin e lartëcekur njehsori elektrik nuk ka qenë në rregull, dhe si të tillë ka pasur defekte teknike.

Sa i përket pretendimit të KESCO që nëse njehsori nuk do të bënte matje të saktë në periudhën e kontestuar, atëherë e njejta do të kishte ndodhur edhe për 20 ditë të muajit tetor, por që, me të njejtin njehsor, shpenzimi është i përafërt sikurse me njehsorin e vjetër dhe se shpenzimi për periudhën kontestuese është real dhe i faturuar drejt sipas shpenzimit të bërë nga konsumatori, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe fatura e nr.1017126638DFE – 10171 e datës 16.10.2020 duhet të korrigjohet duke i marrë për bazë shpenzimet e periudhës së muajit tetor të vitit 2018 me njehsorin e ri elektrik nr.69076545, pasi që faturimi i datës 16 tetor nuk paraqet shpenzim real të energjisë elektrike nga konsumatori.

Bordi i ZRRE-së bazuar në të gjitha shkresa e lëndës, e posacërisht duke e marrë parasysh rrjedhë e energjisë elektrike si dhe procesverbalin e shqyrtimi të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.23445 të datës 22.11.2017 konstaton se faturat nr.08170DFE-10171 të datës 16.08.2017 dhe nr.09170DFE-10171 të datës 15.09.2017 nuk paraqesin shpenzim real të konsumatorit dhe si rrjedhojë, konsumatori për këto dy periudha kontestuese duhet të faturohet bazuar në shpenzimet e periudhës gusht dhe shtator të vitit 2018, sic është vendosur në vendimin e organit të shkallës së parë - DMK.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit R.A. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së